



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 375/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.09.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 977 prot., datë 18.08.2020 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-60175-06-05-2020 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 17.300.000 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.07.2020, nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujesjelles Kanalizime Bulqizë.

**Ankimues:** “Kevenjo” sh.p.k  
Adresa: Lagja e Re, Peshkopi

**Autoriteti Kontraktor:** Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Bulqizë  
Lagja: “Minatori” Bulqizë

**Baza Ligjore:** Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

### **II**

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 08.06.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-60175-06-05-2020 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 17.300.000 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.07.2020, nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujesjelles Kanalizime Bulqizë.

II.2. Në datën 15.07.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 27.07.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.4. Në datën 03.08.2020 ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe ngre pretendime për operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Në datën 10.08.2020 autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit me anë të shkresës nr.368 prot., datë 06.08.2020, duke e refuzuar atë.

II.6. Në datën 18.08.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Me shkresën me nr. 394 prot, datë 27.08.2020, protokolluar me tonën me nr. 977/2 prot, datë 28.08.2020, me objekt *“Informacion mbi procedurën e prokurimit Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit”*, është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Në datën 14.09.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr. REF-60175-06-05-2020 me objekt: *“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove te ujit” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj”*, me fond limit 17.300.000 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.07.2020, nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujesjelles Kanalizime Bulqizë.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues *“Kevenjo” sh.p.k.* për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr. REF-60175-06-05-2020 me objekt: *“Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove te ujit” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj”*, me fond limit 17.300.000 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.07.2020, nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujesjelles Kanalizime Bulqizë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili, në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, pika 1, parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga

operatori ekonomik ankimes sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit Proçedurë e Hapur”, me nr. REF-60175-06-05-2020 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 17.300.000 Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.07.2020, nga autoriteti kontraktor Sh.A Ujesjelles Kanalizime Bulqizë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 977 Protokoli;Datë 18.08.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**